

KAPITULLI VI - PARIMET E IMPLEMENTIMIT PEDAGOGJIK TË KORNIZËS SË KURRIKULIT TË RI TË KOSOVËS

- VI. 1 Organizimi i shkollës – si do të duhet të funksionojë një shkollë në mënyrë që t'i përmbushë kërkesat e kurrikulit të ri**
- VI. 2 Mësimdhënia dhe nxënia: udhëzime metodologjike**
- VI. 3 Çmuarja dhe vlerësimi**
- VI. 4 Veprimtaritë e nxënësve**

VI. 1 Organizimi i shkollës – si do të duhet të funksionojë një shkollë në mënyrë që t'i përmbushë kërkesat e kurrikulit të ri

Me qëllim që t'i përmbushin synimet dhe objektivat e Kornizës së kurrikulit të ri të Kosovës, shkollat duhet të organizohen si **mjedise [institucione] të përshtatshme për mësim**. Kjo do të thotë se shkolla duhet të synojë që nxënësve t'u ofrojë ndjenjën e sigurisë, të një mjedisi të dashur dhe të një vendi ku i kushtohet kujdes zhvillimit personal.

Shkollat do të duhej të kultivonin një **kulturë të re organizative**, në të cilën menaxhimi modern i arsimit vihet në shërbim të arritjeve më të mira në mësim dhe të arsimit të nxënësve që të veprojnë si pjesëmarrës në një shoqëri të lirë dhe demokratike.

Si rrjedhim, shkollat në Kosovë duhet të sigurojnë:

- **Një atmosferë konstruktive dhe të ngrohtë, në të cilën fëmijët ndihen të sigurt dhe të rehatshëm**

Për të arritur këtë qëllim,

- Shkolla duhet të jetë një vend ku respektohet personaliteti i nxënësit, pa kurrfarë diskriminimi lidhur me seksin [gjininë], përkatësinë etnike e religjioze, statusin ekonomiko-shoqëror apo lidhur me dallime të tjera;
- Shkolla duhet të bashkëpunojë ngushtë me familjen;
- Të drejtat e fëmijëve duhet të respektohen në jetën e përditshme shkollore;
- Marrëdhëniet ndërmjet mësuesve dhe nxënësve duhet të mbështeten në respektin e ndërsjellë.

- **Përkujdesje të veçantë për identifikimin dhe zhvillimin e potencialit individual të secilit nxënës**

Për të arritur këtë synim,

- Shkollat duhet t'u kushtojnë vëmendje ritmeve të ndryshme individuale dhe stileve të nxënies;
- Dispozitat e kurrikulit duhet të përshtaten në këtë pikëpamje duke respektuar dallimet individuale për sa u përket ritmeve dhe stileve të nxënies, si dhe përvojën e mëparshme të nxënësit;
- Përparimi i nxënësit duhet të vlerësohet shpesh dhe planifikimi për ballafaqimin e nxënësit me sfida të reja duhet të marrë parasysh rezultatet e mëparshme.

□ **Shkollat duhet t'u ndihmojnë nxënësve të zhvillojnë vetëbesimin, përgjegjësinë dhe shkathhtësitë sociale**

Për të realizuar këtë synim,

- Shkollat duhen të kenë respekt për personalitetin e secilit nxënës;
- Mësuesit duhet të kenë qëndrim pozitiv ndaj nxënësve: ata duhet të besojnë në kapacitetet e nxënësve të tyre, në suksesin e punës së tyre dhe në potencialin ende të pazbuluar të nxënësit;
- Shkollat dhe mësuesit duhet të përkrahin bashkëpunimin ndërmjet nxënësve dhe duhet të sigurojnë suazat përkatëse mësimore, në mënyrë që të nxisin mësim [nxënie] të përbashkët;
- Nxënësit duhet të mbështeten që të planifikojnë të nxënit dhe që të përballen në mënyrë konstruktive edhe me suksese edhe me dështime në mësim.

□ **Një mjedis të dashur për mësim, ku nxënësit mund t'i plotësojnë nevojat e veta arsimore**

Për të realizuar këtë synim,

- Mësuesit, drejtorët e shkollave dhe prindërit duhet të përkujdesen që nxënësit të punojnë në një mjedis të këndshëm dhe të ndiejnë kënaqësi në veprimtaritë shkollore;
- Shkollat duhet të përkujdesen që kërkesat për veprimtari mësimore të jenë në përputhje me moshën e nxënësve dhe me tiparet dalluese të tyre;
- Mësimdhënia dhe nxënia duhet të lidhen me situatat e vërteta të jetës;
- Planifikimi i veprimtarive mësimore në shkolla duhet të fillojë duke marrë parasysh përvojën e mëparshme të nxënësve

□ **Bashkëpunimin ndërmjet mësuesve, ndërmjet mësuesve dhe familjes dhe komunitetit të gjerë**

Për të realizuar këtë synim,

- Puna në shkolla duhet të planifikohet dhe të bashkërenditet me kujdes;
- Marrëdhënia ndërmjet mësuesve duhet të mbështetet në respektin profesional dhe në gatishmërinë që të veprohet në interesin më të mirë të nxënësve;

- Mësuesit duhet të angazhohen në forma të ndryshme të trajnimit, që kanë të bëjnë me trajnimin gjatë shërbimit (punës) dhe me bashkëpunimin me mësuesit dhe shkollat e tjera në kuadër të rrjetit të shkollave, me qëllim të ngritjes së cilësisë së arsimit nga këmbimet e përvojave dhe nga mundësitë e zhvillimit profesional;
- Shkollat duhet të vendosin një mekanizëm për vendimmarrje demokratike dhe për pjesëmarrje aktive të nxënësve, prindërve dhe faktorëve të tjerë në jetën e shkollës.
- Prindërit dhe faktorët e tjerë duhet të ftohen që të marrin pjesë vazhdimisht në proceset e vendimmarrjes lidhur me pjesën sipas zgjedhjes të kurrikulit, lidhur me mjetet mësimore [për nxënie dhe mësimdhënie] dhe në procesin e përmirësimit të kushteve të mësimit [mjedisit mësimor].

□ **Përkujdesjen e veçantë për t'i mësuar nxënësit si të mësojnë**

Për të realizuar këtë synim,

- Mësuesit duhen inkurajuar që rolin të transmetimit të thjeshtë të diturisë t'i shtojnë rolin e lehtësimit të nxënies, duke i zbutur diskutimet, duke i mësuar nxënësit të bëjnë punë të pavarur dhe duke i këshilluar;
- Nxënësit duhet të jenë vazhdimisht në kontakt me burimet e ndryshme të informacioneve dhe t'i përdorin ato, për shembull të mësohen t'u qasen bibliotekave dhe burimeve të mediave/internetit;
- Nxënësit duhet të mbështeten për zhvillimin e një qasjeje kritike ndaj diturisë dhe ndaj mesazheve kulturore;
- Nxënësit duhet të inkurajohen që të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e nxënies; ata duhet të nxiten që t'i shprehin lirisht mendimet, idetë dhe sugjerimet e tyre; të ofrojnë argumente të përshtatshme; të bëjnë pyetje dhe të kultivojnë një frymë të shëndoshë kureshtare.

□ **Zhvillimin e kreativitetit, mendimit kritik dhe çiltërisë e tolerancës**

Për të realizuar këtë synim,

- Shkolla duhet të jetë një vend ku opinioni i nxënësit kërkohet e respektohet dhe ku imagjinata e kreativiteti i nxënësve stimulohen në mënyrë të vazhdueshme;
- Shkolla dhe mësuesit duhet të kultivojnë një qasje konstruktive ndaj nxënësve;
- Shkollat duhet të promovojnë çiltërinë ndaj mënyrave të ndryshme të qasjes në zgjidhjen e problemeve dhe në përballjen me sfida e me situata të reja;
- Duhet të nxiten bashkëpunimi ndërmjet nxënësve dhe mësimi i përbashkët.

□ **Demokracinë në shkollë – mekanizmat përfshirës dhe pjesëmarrës për komunikim e vendimmarrje**

Për të realizuar këtë synim,

- Shkolla duhet të sigurohet se të gjitha informacionet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e mësuesve dhe të nxënësve, janë duke qarkulluar në mënyrë të efektshme dhe se udhëheqja dhe autoritetet e arsimit mund të sigurojnë rikthimin e nevojshëm të informacioneve;
 - Rregullat e brendshme të shkollës duhet të përkufizojnë mënyrën se si mund të bëhen mësuesit dhe nxënësit, prindërit dhe faktorët e tjerë, pjesë e proceseve të vendimmarrjes përfshirëse dhe pjesëmarrës (p.sh. nëpërmjet bordit të shkollës, këshillave të mësuesve dhe të nxënësve, forumeve të nxënësve);
 - Në bashkëpunim me prindërit dhe faktorët e tjerë, shkollat duhet të sigurojnë mjetet e shprehjes për opinionet e nxënësve (p.sh. gazeta e shkollës, radioja e shkollës, mbledhjet e rregullta ndërmjet mësuesve dhe përfaqësuesve të nxënësve, veprimtaritë për këshillim dhe orientim);
 - Nxënësit duhet të ndihmohen të shprehin mirënjohjen dhe të përfitojnë nga të drejtat e tyre; ata duhet të përfshihen në veprimtaritë praktike në të cilat të zhvillojnë përgjegjësinë dhe kujdesin për mjedisin dhe për të tjerët.
- **Arkitekturën e shkollës dhe organizimin e kushteve [ambienteve] të mira të mësim**

Për të realizuar këtë synim,

- Ndërtimi i shkollave të reja dhe rehabilitimi i shkollave ekzistuese duhet të marrë në konsideratë parimet pedagogjike, synimet dhe objektivat e arsimit, të parashikuara me Kornizën e kurrikulit të ri (p.sh. metodat e të mësuarit të përqendruar tek nxënësi, qasjet e ndryshme pedagogjike, përdorimi i mjeteve të ndryshme mësimore, puna e përbashkët, puna projektuese);
- Organizimi i klasës duhet t'u lejojë mësuesve dhe nxënësve të organizojnë dhe të zhvillojnë punën në grupe dhe veprimtari praktike. Mjetet e ndryshme mësimore duhet të jenë në dispozicion të nxënësve në klasa dhe në pjesët e tjera të ndërtesës së shkollës (korridore, bibliotekë, salla të leximit etj.);
- Shkollat duhet t'u sigurojnë nxënësve qasje të lehtë në dhoma dhe në lokale të ndryshme mësimore; ato duhet të jenë të organizuara gjithashtu në atë mënyrë që komunikimi ndërmjet drejtuesve të shkollës, mësuesve dhe nxënësve të zhvillohet lehtë;
- Nxënësve duhet t'u sigurohet një vend i përshtatshëm për tubim, diskutime, mësim dhe argëtim;
- Rekuizitat për edukatë fizike dhe sporte duhet të jenë në gjendje të mirë dhe në përputhje me kërkesat bashkëkohore;
- Shkollat duhet të përpiqen t'u ofrojnë nxënësve kontakt të afërt me natyrën, nëpërmjet kopshteve, parqeve ose serrave.

VI. 2 Mësimdhënia dhe nxënia: udhëzime metodologjike

Synimet dhe objektivat e parashikuara me Kornizën e kurrikulit të ri, mund të arrihen nëse mbështeten në prirjet e reja në metodologjinë e nxënies dhe të mësimdhënies, siç është metodologjia e përqendruar në nxënësin dhe pedagogjia ndërvepruese.

Metodologjia e përqendruar në nxënësin do të thotë se planifikimi dhe organizimi i mësimit [nxënies e mësimdhënies] u kushtojnë vëmendje potencialit, nevojave dhe interesave të nxënësve. Metodatat e nxënies dhe të mësimdhënies përqendrohen në dallimet që kanë të bëjnë me ritmet dhe stilet e nxënies dhe synojnë të stimulojnë pozitivisht interesin e nxënësve dhe motivimin e tyre të përhershëm për të nxënë.

Pedagogjia ndërvepruese do të thotë se mësuesit nxisin komunikimin dhe marrëdhëniet ndërpersonale në klasë, duke siguruar vend për pjesëmarrjen aktive të nxënësve **në ndërtimin e nxënies së tyre**. Në kuadrin e një pedagogjie ndërvepruese, secili nxënës përfshihet në mënyrë aktive në procesin e nxënies dhe ka të drejtë të marrë iniciativë e të bashkojë mendimin e tij me të tjerët. Nxënësit kanë të drejtën për vendimmarrje në lidhje me objektivat dhe përmbajtjet e nxënies, si dhe në lidhje me mjetet e çmuarjes e të vlerësimit. Në kornizën e një pedagogjie ndërvepruese, secili nxënës përfshihet në procesin mësimor dhe ka të drejtë të shfaqë iniciativën dhe të bashkojë mendimin e tij me të tjerë. Nxënësit kanë të drejtë për vendimmarrje në lidhje me objektivat dhe përmbajtjet e mësimit, si dhe në lidhje me mjetet e çmuarjes e të vlerësimit. Ata mund të diskutojnë me mësuesin për të vendosur për llojin e veprimtarisë mësimore dhe për situatat që do të donin t'i përjetonin. Ndërveprimi ndodh jo vetëm ndërmjet mësuesve e nxënësve, por edhe ndërmjet vetë nxënësve. Pedagogjia ndërvepruese përfshin **punën në grup e të mësuarit e përbashkët** dhe përforcon **dimensionin social të proceseve të mësimit**.

Lidhur me nxënien

Nxënia është veçoria dhe aftësia më e zakonshme e qenieve njerëzore. Nëpërmjet proceseve të nxënies, njeriu fiton **dituri, vlera, qëndrime dhe shkathtësi**, si dhe **modele të sjelljes e të veprimtarisë**. Si rezultat i procesit të nxënies, secili njeri është në gjendje të kryejë disa gjëra që nuk i ka ditur dhe nuk ka mundur t'i bëjë para se të kryej ky proces. Nëpërmjet proceseve të mësimit, njeriu mund të përmirësojë po ashtu diturinë dhe shkathtësitë e tij e të zhvillohet vazhdimisht si individ. acquire

Qëllimet e mësimit në shkolla duhet të marrin parasysh trajnimin e nxënësve për një qasje proaktive për sfida personale, profesionale dhe publike në jetë. Praktikatat e nxënies dhe mësimdhënies duhet të theksojnë dhe të stimulojnë procesin e shndërrimit të nxënësve në **“konstruktorë” të nxënies së tyre**. Dituria e parapërgatitur, edhe nëse jepet në mënyrë korrekte dhe të përshtatshme, në asnjë mënyrë nuk mund të zëvendësojë pjesëmarrjen e secilit nxënës në procesin e mbledhjes së diturisë dhe të veprimtimit të veçantë për secilën fushë, në grupin mësimor të cilit i përket nxënësi.

Metodat dhe strategjitë tradicionale të nxënies e mësimdhënies nuk u kushtonin vëmendje sa duhet shkathtësive për komunikim social, për punë në rrjet, për vendimmarrje, për marrjen e rrezikut, për zgjidhjen e problemeve dhe nxitnin vetëm grumbullimin jokritik të

të dhënave faktike dhe koncepteve. Mirëpo dituria e fituar me anë të mësimit në shkollë, nuk është qëllim për vete. Përvetësimi i diturisë duhet të lidhet me zhvillimin e qëndrimeve dhe të zotësive [kompetencave] që janë në gjendje të stimulojnë interesimin dhe aftësinë për pjesëmarrje sociale të nxënësve.

Nxënia nuk duhet të theksohet si një qasje e pjesshme dhe/ose e njëanshme, por si një qasje integrale dhe tërësore. Në procesin e nxënies dalin në shesh të dhëna faktike, koncepte, relacione, vlerat, modele të veprimit dhe qëndrime. Kështu, nxënia në shkollë nuk duhet të kufizohet vetëm në fakte dhe koncepte, por duhet të synojë drejt diturisë, shkathtësive dhe qëndrimeve integrale në strukturat vepruese personale.

Për të qenë të sukseshme, **strategjitë e nxënies dhe të mësimdhënies** duhet të marrin në konsideratë moshën e nxënësve dhe karakteristikat e tyre si mësimarrës, mjedisin e mësimit dhe përdorimin e mjeteve adekuate. Shkollat duhet të sigurojnë një mjedis të favorshëm për mësim, me qëllim që të nxitin një motivim të mbështetur tek secili nxënës. Në vend të një mjedisi mësimi që favorizon konkurrencën e paarsyeshme ndërmjet nxënësve, preferohet një mjedis mësimi i përshtatshëm për mësim grupor, nëpërmjet të cilit nxënësit të mund të zhvillojnë shkathtësitë për zgjidhje ndërvepruese të çështjeve teorike e praktike, në kushte të solidaritetit me shokët e tyre dhe në një konkurrencë të hapur, të ndershme e prodhimtare. Ndërveprimi i nxënësve dhe veprimtaria në grupe të vogla duhet të shoqërohen me një dinamikë stimuluese të grupit dhe me përqendrimin e anëtarëve të tij në çështje të rëndësishme me mundësi të larta edukimi.

Nxënia në shkollë duhet të krijojë themele të forta për të mësuarit gjatë tërë jetës. Nxënësit duhet të kenë në dispozicion mjete të nevojshme për të ruajtur dëshirën e flakët të përgjeshme për të mësuar dhe për t'iu qasur burimeve e resurseve të mësimit. Të mësuarit në shkollë mund të jetë i efektshëm nëse nxënësit mund të kuptojnë lidhjen ndërmjet vendimmarrjes (që varet nga kushtet e caktuara të informimit dhe nga zotërimi i disa shkathtësive instrumentale) dhe cilësisë së jetës së njeriut. Përshtatja krijuese ndaj ndryshimeve nuk mund të stimulohet me anë të nxënies së mbështetur mbi metoda sterile të mësimdhënies, të cilat nuk kanë tjetër qëllim veçse të riprodhojnë rregulla dhe dogma të shoqëruara me skolasticizmin akademik.

Lidhur me mësimdhënien

Proceset dinamike të zhvillimit në shoqëri, shkencë, kulturë dhe teknologji kanë ndikuar dhe kanë mundësuar ndryshime në metodat, mjetet dhe format e organizimit të mësimdhënies. Kjo ka për pasojë një ndryshim substancial në rolin e nxënësve, të mësuesve, të prindërve dhe të faktorëve të tjerë në komunitet.

Mësimdhënia bashkëkohore theksohet si mjet për të lehtësuar proceset e nxënies dhe zhvillimin individual të nxënësve si mësimarrës. Ajo nuk shikohet më si mjet më vete, por si mënyrë për të inkurajuar dhe trajnuar nxënësit që të jenë aktivë në procesin e mësimit [e mësimdhënies dhe nxënies]. Gjatë procesit të mësimit [të mësimdhënies e nxënies], mësuesit duhet t'u kushtojnë vëmendje nevojave:

- për të zhvilluar iniciativën dhe pavarësinë e nxënësve si mësimarrës;
- për të zhvilluar përgjegjësinë e nxënësve për të arriturat e tyre në nxënien;
- për të theksuar nevojat, interesimet dhe talentet e ndryshme të nxënësve;
- për të përfshirë në mënyrë aktive veçan secilin nxënës;
- për të zhvilluar shkathtësitë komunikative dhe shkathtësitë e tjera shoqërore;
- për të zhvilluar shkathtësitë e vetëvlerësimit tek nxënësit;
- për të zhvilluar shkathtësitë organizative dhe të punës, siç janë ndarja e përgjegjësisë, gjetja e informacionit të duhur, vendosja e kufijve kohorë për plotësimin e detyrave të ndryshme, duke vendosur për përdorimin e mjeteve të ndryshme për të lehtësuar dhe siguruar rezultate të pritshme në mësim.

Baraspeshimi i përdorimit të metodave tradicionale dhe moderne të mësimdhënies dhe nxënies

Metodat tradicionale të mësimdhënies dhe të nxënies përqendrohen vetëm në stimulet verbale e në perspektivat abstrakte dhe theksojnë më shumë veprimtarinë e mësuesit në klasë sesa mënyrat për t'i përfshirë nxënësit në mënyrë aktive në ndërtimin e sistemit të tyre të nxënies. Ato shpesh janë kritikuar për vendosjen e një komunikimi të njëanshëm në klasë, për një pjesëmarrje më shumë pasive të nxënësve në proceset e mësimin dhe për një didaktikë të orientuar në mësuesin dhe në lëndën. Filozofia mbi të cilën ndërtohen metodat më shumë tradicionale të mësimdhënies e nxënies, u referohen mësuesve si më shumë të dijshtëm se nxënësit dhe si burim kryesor (ngandonjëherë i vetëm) i nxënies për ta.

Por të ashtuquajturat metoda tradicionale (p.sh. mbajtja e leksioneve ose sesionet pyetje-përgjigje, të bazuara në të mbajturit mend të vrazhdë dhe në riprodhimin e njohurive, duke stimuluar vetëm shkathtësitë intelektuale të nivelit të ulët), megjithë të metat e tyre, kanë epërsi, sepse nuk marrin kohë, sa marrin metodat moderne-bashkëkohore.

Metodat bashkëkohore synojnë të baraspeshojnë stimulet verbale me stimulet e tjera, si rezultat i përdorimit tërësor të shqisave të njeriut dhe të potencialit intelektual, emocional e psikomotorik të nxënësve. Ato po ashtu synojnë të shtyjnë përpara nxënien sociale, me anë të organizimit ndërveprues të veprimtarive të nxënësve, siç është puna me shokë ose puna grupe/ekipore. Ato gjithashtu synojnë të lidhin më mirë teorinë dhe praktikën, nëpërmjet veprimtarive praktike ose ushtrimeve, siç është puna projektuese, e cila mbështetet në përvojën e nxënësve dhe në pjesëmarrjen e tyre personale në zgjidhjen e problemeve dhe në kryerjen e detyrave në mënyrë individuale ose si ekip.

Filozofia mbi të cilën ndërtohen metodat bashkëkohore, bazohet në supozimin se nxënësit mësojnë më mirë kur mësojnë duke vepruar, domethënë kur sfidohen për t'u angazhuar që t'i qasen nxënies në mënyrë aktive dhe krijuese. Në përputhje me këtë perspektivë, nxënësit dhe mësuesit janë partnerë në kërkimin e nxënies, dhe roli i mësuesit është kryesisht që t'i orientojë, t'u ndihmojë dhe të mbështetë përpjekjet e nxënësve për fitimin dhe zhvillimin e diturisë, shkathtësive dhe qëndrimeve. Metodat bashkëkohore synojnë

po ashtu të nxitin nxënien e përbashkët, duke stimuluar përparimin në bazë të ndërveprimit të ndërsjellë dhe të ndarjes së detyrave në grupin mësimor. Metodat bashkëkohore mund të nënkuptojnë po ashtu përdorimin e teknologjive bashkëkohore të informacionit dhe të komunikimit, si dhe përdorimin e disa mjeteve bashkëkohore mësimore, siç janë kinoprojektorët dhe transparencat, këmbalecat [“flip-charts”], tabelat magnetike, programet kompjuterike (softuerët) etj.

Mësimdhënia e mirë nuk nënkupton automatikisht vetëm përdorimin e metodave më shumë “bashkëkohore”. Metodat bashkëkohore nënkuptojnë trajnimin metodologjik dhe shkathtësi të mira organizative. Puna grupore ose puna projektuese kërkon një përgatitje të mirë dhe njohuri teknike metodologjike solide. Ngandonjëherë, mësimdhënia e mirë mund të jetë rezultat i përdorimit bashkëkohor të metodave “tradicionale”. Për shembull, të nxënë të mirë mund të frymëzohet nga një leksion i ndriçuar, i cili strukturohet në mënyrë ndërvepruese, duke lënë vend për pyetje, komente dhe për mënyra të tjera të pjesëmarrjes aktive të nxënësve.

Mësuesit duhet t’i kushtojnë vëmendje nevojës për të baraspeshuar metodat “tradicionale” dhe bashkëkohore dhe për të përshtatur metodat e tyre në përputhje me karakteristikat e nxënësve të tyre dhe në përputhje me synimet e objektivat e proceseve dhe situatave të ndryshme të nxënies. Në të njëjtën kohë, mësuesit duhet t’i kushtojnë vëmendje nevojës për të futur më së miri në përdorim resurset njerëzore e materiale në mjedisin e tyre specifik.

Roli i mësuesit

Po të marrin parasysh nevojën për të përkrahur në shkollë një qasje të përqendruar tek nxënësi dhe metodologjitë ndërvepruese, si dhe të mësuarit e përbashkët e shkathtësitë e përgjeshme të nxënies, me synimin për të ngritur nivelin e nxënies, – mësuesit nuk mund të konsiderohen më vetëm si transmetues të informacioneve dhe të njohurive sistematike e të sakta. Nga perspektiva e një qasjeje didaktike bashkëkohore, funksionet e mësuesit janë zgjeruar së tëpërmi.

Mësuesit si lehtësues të nxënies

Një prej roleve kryesore të mësuesve është të disenjojnë veprimtaritë kuptimplota të nxënies dhe të ofrojnë përvojat kuptimplota të nxënies për nxënësit e tyre, me qëllim që të sigurohen se synimet dhe objektivat e arsimit janë arritur dhe se zhvillimi personal i nxënësve është duke përparuar në mënyrë të vazhdueshme. Mësuesit duhet të jenë në gjendje të shfaqin entuziazmin dhe t’i motivojnë nxënësit që t’i qasen nxënies me entuziazëm. Ata do të duhej të ishin në gjendje t’u shpjegojnë nxënësve pse mësimi është me rëndësi dhe t’i bënin që të jenë në dijeni për synimet dhe objektivat e mësimin, t’i kuptojnë ato dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive për vendosjen e tyre. Mësuesit duhet të jenë në gjendje të japin mesazhe të qarta e të sakta dhe të ndërlidhin në mënyrë të baraspeshuar teorinë me praktikën. Ata po ashtu duhet të jenë në gjendje të kontribuojnë

vazhdimisht, nëpërmjet shembullit të tyre personal të të qenit i qytetëruar dhe profesionist, në arsimimin për qytetarinë demokratike në Kosovë.

Me qëllim që të organizojë punën në klasë, mësuesi vepron në përputhje me dallimet specifike në klasë, me përmbajtjen e lëndës, grupin moshor, hapësirën dhe materialet mësimore në dispozicion. Mësuesit duhet të jenë në gjendje të planifikojnë veprimtaritë e nxënësve nga pikëpamja e strategjive të ndryshme të mësimdhënies e të nxënies, të cilat përveç dallimeve të lartpërmendura, përfshijnë po ashtu edhe filozofitë specifike rreth faktit që nxënia të jetë sa më e efektshme (p.sh. qasjet induktive, deduktive ose të kombinuara; të mësuarit algoritmik ose të mësuarit nëpërmjet gjurmimit në mënyrë krijuese të lëmenjve të rinj; të mësuarit të përqendruar më shumë në përdorimin e stimuleve verbale ose të mësuarit të përqendruar më shumë në përdorimin e shqisave).

Mësuesit si zhvillues të kurrikuleve

Kurrikuli i ri u lejon mësuesve që t'i qasen mendueshëm dhe në mënyrë krijuese planifikimit të veprimtarive mësimore në klasën e tyre. Mësuesit duhet të lexojnë dhe të diskutojnë me kolegët e tyre, me prindërit e me nxënësit në lidhje me kërkesat e kurrikulit (cilat objektiva të mësimit, cilat përmbajtje, cilat metoda dhe cilat procedura të çmuarjes e të vlerësimit rekomandohen) dhe dispozitat t'i përshtatin në mënyrë krijuese me veçoritë dhe nevojat e nxënësve të tyre. Mësuesit po ashtu duhet të angazhohen rreth disenjimit specifik të pjesës sipas zgjedhjes të kurrikulit, d.m.th. të planifikimit të kurseve dhe veprimtarive sipas zgjedhjes, të përcaktuara nga shkolla, të disenjimit të veprimtarive jashtëkurrikulare, si dhe të disenjimit të planeve të mësimit individual, për nxënësit që kanë nevojë për kujdes e përkujdesje të veçantë.

Mësuesit si autoritete epistemike

Për nxënësit mësuesit mund të paraqesin autoritet epistemik, për shkak të diturisë dhe përvojës së tyre për gjetjen dhe trajtimin e informacioneve të nevojshme. Mësuesit po ashtu mund të jenë modele të të menduarit, të të folurit, të ligjërimit, të organizimit dhe të prezantimit të një teme të caktuar, që ka të bëjë me mënyra e mjete veprimi, dhe po ashtu edhe si model për përdorimin e teknologjive të informacionit, të komunikimit dhe të mësimit, të cilat mund të futen në punë në proceset mësimore.

Mësuesit si moderatorë

Nga perspektiva e pedagogjisë ndërvepruese, komunikimi në klasë duhet të nxitet dhe nxënësit duhet të mbështeten në angazhimin në dialog kuptimplotë me mësuesit dhe kolegët e tyre. Nxënësit duhet të inkurajohen të shprehin mendimet e tyre duke futur në punë argumente të vlefshme dhe të tregohen të qytetëruar në dialogë me të tjerët. Ata duhet të mbështeten që të mësohen të dëgjojnë të tjerët, të respektojnë

mendimet e të tjerëve dhe të mbrojnë në mënyrë të qytetëruar pikëpamjet e veta. Mësuesit duhet të veprojnë si moderatorë (ndërmjetësues) të diskutimeve në klasë, dhe të përkujdesen që të zhvillohet një dialog i vërtetë. Nuk duhen shmangur çështje të ndjeshme dhe polemizuese, por ato duhen transformuar nga mësuesit, si moderatorë, në përvojë kuptimplotë të nxënies.

Mësuesit si aktorë

Në disa situata, mësuesit duhet të aktrojnë në mënyrë bindëse, me qëllim të stimulimit të interesimit dhe të motivimit të nxënësve për mësim. Ata duhet të demonstrojnë shkathtësi empatike, përqendrimin, humorin, gjallërinë dhe aftësinë për të mobilizuar nxënësit drejt qëllimeve të caktuara

Mësuesit si menaxherë të klasës

Menaxhimi përfshin planifikimin, organizimin, përndarjen e detyrave, marrjen e vendimeve, monitorimin dhe kontrollin. Ai po ashtu përfshin trajtimin kuptimplotë të ndërveprimeve të njerëzve, zgjidhjen paqësore të konflikteve dhe përdorimin sa më të mirë të resurseve njerëzore dhe materiale. Mësuesit duhet të planifikojnë me kujdes situatat e mësimin dhe përvojat për nxënësit e tyre, në pajtim me synimet dhe objektivat e Kurrikulit të ri të Kosovës dhe të kurrikuleve specifike të lëndëve dhe të programit mësimor (silabit). Ata duhet të planifikojnë përdorimin e metodave dhe të mjeteve mësimore, e po ashtu edhe të mënyrave sipas të cilave do të punonin nxënësit (p.sh. pavarësisht, me shokë, në grupe ose individualisht), në përputhje me suazat dhe resurset vendore. Mësuesit duhet të bëjnë çmarrjen dhe vlerësimin e veprimtarive dhe performancave të nxënësve dhe duhet të përkujdesen që gjatë gjithë kohës të sigurojnë një mjedis miqësor të ngrohtë e të frytshëm të mësimin. Mësuesit po ashtu duhet të përgatiten për të vlerësuar performancat e veta, të marrin parasysh rikthimin e informacioneve nga nxënësit, kolegët e prindërit dhe të bëjnë të mundshëm përmirësimin e performancave të tyre profesionale.

Mësuesit si mentorë dhe këshilltarë

Mësuesit duhet t'u ofrojnë këshillime nxënësve dhe prindërve, në drejtim të kërkimit të zgjidhjeve për lloje të ndryshme të problemeve që nxënësit dhe prindërit e tyre mund të takojnë. Ata mund të angazhohen në këshillime lidhur me çështje dhe probleme të mësimin, që kanë të bëjnë me zhvillimin vetjak dhe me ndërveprimin midis njerëzve. Ata po ashtu duhet të angazhohen në këshillime lidhur me orientimin profesional dhe me orientimin që ka të bëjë me studimet e mëtejshme. Mësuesit duhet të jenë në gjendje të identifikojnë fuqitë dhe dobësitë e nxënësve të tyre, me qëllim që të zbulojnë potencialet ende të pazbuluara të nxënësve të tyre. Temat, siç janë arsimimi për shkathtësi jetësore, edukimi shëndetësor, edukimi seksual, arsimimi mbi mjedisin, zgjidhja e konflikteve e të

tjera, – duhet të konsiderohen si objektiva ndërkurrikulare dhe detyra për shkollën si institucion i arsimit dhe për komunitetin.

Si mentorë, mësuesit duhet t’i udhëheqin nxënësit e tyre gjatë zhvillimit të tyre personal dhe duhet të përpiqen t’u ndihmojnë që të zhvillojnë plotësisht potencialin e tyre.

Mësuesit si specialistë të arsimit dhe si hulumtues

Ekspertiza pedagogjike e mësuesve duhet të përmirësohet vazhdimisht me anë të leximit e shkrimit vetjak, pjesëmarrjes në veprimtaritë e trajnimit gjatë shërbimit dhe me anë të angazhimit në kërkime vepruese, që synojnë të përmirësojnë shkathtësitë profesionale dhe performancat e tyre, si dhe ato të një suaze të caktuar arsimore, duke vënë në përdorim metoda dhe praktika të reja. Mësuesit duhet të mbajnë të gjallë kureshtjen e tyre lidhur me çështjen si të mësojnë më mirë nxënësit dhe të jenë në kontakte me risitë në fushën e kërkimeve dhe të praktikës pedagogjike. Mësuesit duhet të angazhohen në veprimtaritë e organizatave profesionale, nëpërmjet të cilave mund të marrin dhe të këmbëjnë informacionet e duhura. Ata duhet të angazhohen në veprimtaritë e partneritetit dhe të punës në rrjetin kompjuterik dhe të përpiqen të futin në punë krijuese praktikatat e mira të mësimdhënies e të nxënies në klasën e tyre.

VI. 3 Çmuarja dhe vlerësimi¹

Çmuarja dhe vlerësimi i nxënësve përfshijnë aspektet cilësore dhe sasiore. Edhe çmuarja edhe vlerësimi i arritjeve të nxënësve duhet të bazohen në standarde, të cilat mund të jenë standarde të përmbajtjes (në lidhje me diturinë dhe shkathtësitë), standarde të performancave (në cilin nivel të performancave nxënësit e vendosin vetveten në lidhje me diturinë e shkathtësitë specifike), një mundësi e standardeve mësimore (të cilat i orientojnë mësuesit, nxënësit dhe prindërit në lidhje me masën e përpjekjes që nxënësi duhet ose rekomandohet të përballojë. Ndërsa çmuarja mund të përmbajë më fort aspekte cilësore, vlerësimi rëndom bazohet në kritere të rrepta dhe përfshin më fort matjen dhe testimin.

Në shkolla, mund të merren në konsideratë forma dhe funksione të ndryshme të çmuarjes e vlerësimit, në pajtim me qëllimet e ndryshme të çmuarjes dhe vlerësimit

Pse janë të nevojshme çmuarja dhe vlerësimi?

¹ Një dokument zyrtar lidhur me reformën e çmuarjes dhe vlerësimit në sistemin arsimor të Kosovës është në përgatitje e sipër në Bankën botërore (World Bank), si agjenci prirëse për çmuarje e vlerësim. Ky dokument do të vendosë parimet themelore për reformën e çmuarjes e vlerësimit në Kosovë, me synimin për të paraqitur bazën për zhvillimin e çmuarjes e të vlerësimit dhe të standardeve të kurrikulit në një të ardhme të afërt.

Nxënësit mund të çmohen e të vlerësohen për arsye të ndryshme, siç janë:

- për të identifikuar fuqitë dhe dobësitë e tyre (qasja diagnostike);
- për të vërtetuar se cili është niveli i performancave të një nxënësi në një lëmë të caktuar, në fillim, gjatë procesit të mësimit ose në fund të një faze/shkalle të caktuar të mësimit;
- për të vërtetuar nëse janë duke përparuar nxënësit në zhvillimin e tyre;
- për të stimuluar dhe për të orientuar përparimet e nxënësve;
- për të përfutur rezultate krahasimtare, të cilat mund të jenë të rëndësishme për një nxënësi të caktuar, për shkollën, për sistemin shkollor etj.;
- për të siguruar hierarkinë dhe për të përdorur rezultatet e vlerësimit për proceset e përzgjedhjes të llojeve të ndryshme;
- për të stimuluar motivimin e nxënësve për mësim;
- për të siguruar parashikimet për zhvillimin e nxënësve, duke pasur parasysh karrierën e tyre dhe orientimin e ardhshëm;
- për të gjurmuar se sa janë të përshtatshëm, të efektshëm etj. kurrikuli, metodologjia e mësimdhënies dhe e nxënies apo mjetet mësimore.

Mjetet e çmuarjes e të vlerësimit. Përdorimi i mjeteve tradicionale dhe “alternative”

Çmuarja duhet të orientohet edhe **drejt proceseve të mësimit edhe drejt prodhimeve të mësimit**. Për të qenë e efektshme, çmuarja duhet të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe të mbështetet mbi një larmi metodash, procedurash dhe mjetesh. Përveç praktikave më shumë tradicionale të vlerësimit (provimet me shkrim, pyetjet dhe përgjigjet me gojë), mësuesit duhet të zbatojnë më shumë mënyra të ndryshme për të çmuar nxënësit e tyre, të cilat përfshijnë vështrimet e tij gjatë punës grupore, çmuarja e punës projektuese, dosjet e nxënësit, çmuarja e punës së nxënësit në shtëpi, çmuarja e punës specifike, e shkathtësisë komunikative dhe e punës ekipore etj. Rezultatet e çmuarjes së nxënësve duhet t'u komunikohen prindërve rregullisht.

Çmuarja duhet të synojë të kontribuojë në përparimin e nxënësve dhe duhet të konsiderohet si një mjet për motivimin e nxënësve që të bëjnë përpjekje të arsyeshme për arritje më të mira. Çmuarja dhe vlerësimi nuk duhen konsideruar sikur një mjet për dënimin apo kërcënimin e nxënësve, por si mjet për stimulimin konkret të tyre. Nxënësit dhe prindërit duhen përfshirë në proceset e bisedimeve me stafin e shkollës për procedurat dhe mjetet për çmuarje e vlerësim.

Vlerësimi lidhet me matjen, dhe përfshin më tepër procedurat e orientuara në sasi, duke përfshirë testimin.

Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm

Procedurat e vlerësimit mund të zhvillohen dhe të administrohen në shkallë shkolle. Në këtë rast, kemi të bëjmë me **vlerësim të brendshëm**, të bazuar në parimete autonomisë së shkollës. **Vlerësimi i jashtëm** do të thotë se mjetet dhe procedurat e vlerësimit zhvillohen jashtë shkollave, nga agjenci të specializuara, të cilat kanë të drejtë të administrojnë

mjetet e vlefshme të vlerësimit, në bazë të të cilave supozohet se mund të bëhen renditjet hierarkike të besueshme dhe përzgjedhja në shkallë më të gjerë (në shkallë komune, në shkallë rajonale apo në shkallë kombëtare).

Vlerësimi i standardizuar i jashtëm i nxënësve parashikohet të kryhet në shkallë kombëtare në fund të secilës nga tri shkallët e arsimit formal: në fund të klasës së 5-të (mbarimi i arsimit fillor); në fund të klasës së 9-të (mbarimi i arsimit të mesëm – i shkollës së mesme); në fund të klasës së 12 (mbarimi i arsimit të mesëm të lartë).

Në fund të klasës së 5-të (mbarimi i arsimit fillor), nxënësit do të provohen në lidhje me aftësitë e tyre për të lexuar dhe për të shkruar në gjuhë amtare, si dhe me aftësinë e llogaritjes me numra. Ky vlerësim organizohet me qëllim të përfundimit të një pasqyre përkatëse lidhur me efektshmërinë e shërbimeve arsimore për sigurimin e arsimit elementar në shkolla fillore.

Vlerësimi i nxënësve në fund të arsimit të detyrueshëm (mbarimi i klasës së 9-të dhe mbarimi i arsimit të mesëm) do të organizohet si provim i përfundimit të shkollës (14 plus – që do të thotë se nxënësit mund të japin këtë provim edhe në një fazë-shkallë më të vonshme të jetës së tyre). Ky provim do të përqendrohet në arritjet e nxënësve në lëndët e detyrueshme, po ashtu edhe në lëndët zgjedhore në kurrikul, duke marrë parasysh dimensionin teorik dhe dimensionin praktik të mësimi².

Rezultatet e këtij provimi të përfundimit të shkollës do të merren parasysh për regjistrimin e nxënësve në arsimin e mesëm të lartë. Për këtë qëllim mund të merren parasysh edhe rezultatet e arritura gjatë katër vjetëve të arsimit të mesëm. Një formulë e mundshme do të ishte që rezultateve të provimit të përfundimit të shkollës (p.sh. 60%, apo 70% a 75%, të notave) t'i shtohen rezultatet e katër viteve të shkollës së mesme (p.sh. 40%, apo 30% a 25%, të notave), ose të merren parasysh vetëm rezultatet nga lëndët e caktuara që përputhen me drejtimit përkatëse në të cilat dëshirojnë të regjistrohen nxënësit.

Pranimi i nxënësve në arsimin e mesëm të lartë mund të kushtëzohet me marrjen e provimit të përfundimit të shkollës (14+), ndërsa pranimi i nxënësve në shkollat profesionale nuk do të duhej të varej nga kjo. Pra provimi i përfundimit të shkollës nuk do të duhej të ishte i detyrueshëm.

Standardet që përdoren për të përpiluar testet, do të duhej të pasqyronin objektivat e përgjithshme të arsimit, të cilat merren parasysh për secilën shkallë të shkollimit dhe për secilin lëmë ose lëndë të kurrikulit.

Në fund të klasës së 12-të (mbarimi i arsimit të mesëm të lartë – i gjimnazit), duhet të organizohet provimi i maturës (i pjekurisë), si vlerësim i jashtëm. Rezultatet e provimit të maturës duhet të merren parasysh për regjistrim në arsimin universitar.

² Struktura dhe procedura për këtë provim do të rregullohen nga autoriteti qendror i arsimit për Kosovë.

Në fund të arsimimit profesional, duhen të organizohen provimet e standardizuara për të marrë certifikatën profesionale.

Vlerësimi me notë dhe performanca e pranuar

Në sistemin e arsimit të Kosovës, vlerësimi me notë bazohet në notat 1 deri 5. Nota “1” paraqet performancën e papranueshme [notë pakaluese], e cila nënkupton mbetjen në klasë dhe nxënësin e detyron ta përsërisë klasën (vitin) e caktuar

Me qëllim të ngritjes së motivimit pozitiv të nxënësve gjatë viteve të para të shkollimit fillor (klasat 1 dhe 2 – faza kryesore *përvetësimet themelore* të kurrikulit), notat mund të zëvendësohen me vlerësim përshkrues (p.sh. “shumë mirë”, “mirë”, ‘mjaftueshëm’, “dobët”). Në arsimin fillor (klasat 1 deri 5), nxënësit nuk mund të shpallen mbetës, por ata duhet të kenë çdo mbështetje të mundshme në mënyrë që të përparojnë në përputhje me potencialin e tyre.

VI. 4 Veprimtaritë e nxënësve

Me qëllim të organizimit si duhet të veprimtarive të nxënësve, duhen marrë parasysh disa parime:

- **Nxënësit duhen mbështetur në zhvillimin e vetëbesimit gjatë procesit mësimor; ata duhet të nxiten në mënyrë të vazhdueshme dhe të stimulohen konkretisht. Sfidat e nxënies duhet të mbështeten në sukseset e tyre të mëparshme.**
- **Një atmosferë konstruktive dhe jokërcënuese mund të ndikojë që të arrihen rezultate më të mira në mësim.**
- **Nxënësit mësojnë më mirë nëse janë të përfshirë në mënyrë aktive në konstruktimin e nxënies së tyre. Kjo sjellë si rezultat një vetangazhim më të madh dhe një vetëdisiplinë e përgjegjësi më të madhe.**
- **Nxënësit duhet të mbështeten që ta kuptojnë se nxënia e mirë është mësim i tërësishëm dhe i integruar. Ata duhet të mbështeten për të kuptuar lidhjet ndërmjet lëmenjve të ndryshëm të kurrikulit dhe lëndëve, si dhe të angazhohen që t’u qasen çështjeve e shkathtësive ndërkurrikulare.**
- **Nxënësit mësojnë më mirë kur e kuptojnë lidhjen praktike ndërmjet çështjeve të ndryshme dhe nëse mund të ndërlidhin teorinë me praktikën në zgjidhjen e problemeve në situatat e përditshme të jetës.**
- **Nxënësit mësojnë më mirë po të kenë hapësirë të shfaqen në mënyrë krijuese dhe për të futur në punë kureshtjen dhe kërkimin hulumtues të tyre.**
- **Nxënësit mësojnë më mirë kur e dinë se cilat janë objektivat e nxënies dhe cili është fitimi i tyre vetjak pas përfundimit të procesit të nxënies.**
- **Nxënësit mësojnë më mirë nëse ndiejnë gëzim dhe dëfrim gjatë procesit të nxënies dhe kur metodat e mësimdhënies e të nxënies përdoren në përputhje me karakteristikat e tyre individuale si mësimarrës.**

- Nxënësit mësojnë më mirë kur janë në gjendje të kuptojnë rëndësinë e çështjeve e shkathtësive të ndryshme për jetën dhe profesionin e tyre të ardhshëm.

Në shkollë nxënësit duhet të inkurajohen të punojnë në mënyrë të pavarur. Puna e pavarur e nxënësve mund të organizohet në mënyrë individuale, në çifte ose në ekipe/grupe prej 4-5 ose më shumë nxënësish. Veprimtaritë dhe ushtrimet e grupeve të vogla janë veçanërisht të rëndësishme për zhvillimin e shkathtësive sociale dhe të shkathtësive bashkëpunuese të të mësuarit. Është me rëndësi të përdoren veprimtaritë dhe ushtrimet me grupe të vogla, me qëllim të përgatitjes së nxënësve për punë ekipore në adoleshencë. Siç shihet nga përvojat e shumta ndërkombëtare, për shkak të ndarjes së punës dhe ndërliqshmërisë së veprimtarive në punë të sotme, puna ekipore është e pranishme përherë në jetën profesionale dhe publike, prandaj (kjo formë) tashmë kërkon vëmendje të posaçme në shkolla.

Puna e pavarur e nxënësve nuk duhet të organizohet si një veprimtari e mërzitshme dhe monotone, por duhet të drejtohet tek sfida dhe detyra krijuese, siç është puna projektuese, nëpërmjet së cilës nxënësit duhet të përgatitin një zgjidhje për një problem të caktuar, duke futur në punë diturinë e shkathtësitë e ndryshme dhe aftësitë në sferën e njohjes.

Në organizimin e veprimtarive të nxënësve, mësuesit duhet të përfshijnë nxënësit, e po ashtu edhe prindërit. Këto veprimtari duhet të theksojnë personalitetin e nxënësit në tërësi, e jo vetëm shkathtësitë intelektuale dhe sferën e njohjes.

Veprimtaritë e pavarura të nxënësve duhet të nxiten nëpërmjet veprimtarive kurrikulare dhe jashtëkurrikulare, dhe ato duhen të synojnë:

- zhvillimin e imagjinatës, iniciativës e kreativitetit dhe përdorimin krijues të diturisë e shkathtësive të fituara;
- zhvillimin e shkathtësive të organizimit dhe të planifikimit;
- zhvillimin e shkathtësive të punës ekipore dhe të shkathtësive sociale;
- zhvillimin e aftësisë për t'iu qasur çështjeve dhe detyrave të ndryshme nga perspektivat ndërdisiplinare dhe ndërkurrikulare;
- zhvillimin e shkathtësive të vlerësimit e të vetëvlerësimit.

Veprimtaritë (e pavarura) të nxënësve duhet të jenë kuptimplota dhe të kontribuojnë në konsolidimin e të mësuarit. Ato nuk duhet t'i mbingarkojnë nxënësit dhe duhet të përqendrohen në mënyrë realiste në potencialin që duhet zhvilluar tek nxënësit.

Rezultatet e veprimtarive të nxënësve duhet të regjistrohen (p.sh. në dosje të nxënësve) dhe të merren parasysh për çmuarje e vlerësim, jo vetëm të shkathtësive intelektuale dhe të arritjeve në sferën e njohjes, por edhe për sa u përket sferave emocionale dhe psikomotorike.